



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

Bazuar në nenin 28 par.4 të Ligjit për Avokatinë lidhur me nenin 83 par.2 të Statutit të OAK, Këshilli Drejtues i Odes së Avokatëve të Kosovës në seancën e mbajtur më 28 dhjetor 2013 nxjerr:

**RREGULLORE PËR KUSHTET HAPËSINORE DHE TEKNIKE TË
ZYRAVE TË AVOKATISË**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet kushtet hapësinore, teknike dhe pajisjet minimale të zyrave individuale, Zyrave të përbashkëta apo Shoqërive të Avokateve.

Neni 2

1. Kandidati për regjistrim në regjistrin e avokateve duhet të kenë hapësirën e përshtatshme për zyrë, në sipërfaqe me së paku 20 m², e cila përbëhet prej:
 - hapësirës për avokat,
 - hapësirës së pritjes e cila mund të shërbejë edhe si zyrë për asistent apo praktikant,
 - Tualet.
2. Zyrat e përbashkëta dhe Shoqëritë e avokatëve, përveç përmbushjes së kritereve nga paragrafi 1 i këtij duhet të kenë hapësirën shtese prej 10 m² për çdo avokat.
3. Në hapësirat e Zyrave individuale, Zyrave të përbashkëta apo Shoqërive të Avokatëve nuk mund të ofrohen apo promovohen shërbime tjera përveç shërbimeve të avokatisë.

II. PAJISJET

Neni 3

1. Zyrat individuale, Zyrat e përbashkëta apo Shoqërive të Avokatëve duhet të kenë pajisje të përshtatshme, e cila është thelbësore për profesionin e avokatit, veçanërisht:
 - Një tavolinë pune për avokat
 - Një tavolinë pune për asistent/praktikant, nëse ka.
 - Kabineti/dollap për dosje
 - Kompjuter me qasje në internet
 - Telefon
 - Adresë elektronike aktive

III. VLERËSIMI I HAPËSIRAVE DHE PAJISJEVE

Neni 4

1. Vlerësimin e përshtatshmërisë së hapësirave dhe pajisjeve të nevojshme e bënë komisioni prej tre anëtarësh.
2. Komisioni përbëhet nga Drejtori Ekzekutiv i OAK dhe dy anëtarë të tjerë të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues i OAK.

Neni 5

1. Kandidati për regjistrim në regjistrin e avokateve të OAK duhet ti paraqes Komisionit dëshminë për posedimin e lokalit për zyrë.
2. Komisioni pas vlerësimit të kushteve të zyrës të parapara me nenin 1 të kësaj Rregulloreje, do të nxjerrë konkluzion mbi përshtatshmërinë e hapësirave, të nënshkruar nga tre anëtarët e Komisionit, i cili i dorëzohet palës dhe Këshillit Drejtues të OAK.

IV. NDËRRIMI I ZYRËS SË AVOKATISË

Neni 6

1. Avokatet obligohen që në afat prej 15 ditë ta njoftojnë Odën e Avokatëve për ndërrimin e zyrës së avokatisë.
2. Pas njoftimit Komisioni brenda 30 ditëve bënë vlerësimin e kushteve të zyrës së re.
3. Në rast të mosplotësimit të kushteve Komisioni e njofton Këshillin Drejtues.

Neni 7

Oda e Avokatëve do të publikojë njoftimin për hapjen ose ndërrimin e zyrave të avokateve në mjetet e informimit të OAK.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 8

Avokatët e licencuar duhet ti plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë së hapësirave dhe pajisjeve sipas kësaj Rregulloreje, jo më vonë se 30 Qershor 2015, përndryshe atyre do të ju pezullohen licencat deri në përmbushjen e këtij detyrimi.

Neni 9

Rregullorja hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe zbatohet nga data 01 Janar 2014.

Av. Ibrahim Z. Dobruna,
Kryetari i OAK-së